



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:167767

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06069179

**P.nr.2024:212532**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-** DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.N., nga Fshati ..., Komuna Shtime, për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo i mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Themelore në Ferizaj PP/II.nr.557/24 e dt.02.07.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 19.08.2024, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të akuzuarit R.N. dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av. Nexhat Qorrolli, të njëjtën ditë mori dhe publikisht, kurse me datën 21.08.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Kundër të akuzuarit:

**R.N.**, nga Fshati ..., Komuna Shtime, i lindur me datë ..., nga babi A., dhe nëna M., mbiemri i vajzërisë së nënës R., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër persona ..., mbrohet ne liri.

### Ë S H T Ë F A J T O R

**-I-**

**Sepse:** Se që nga data e pavërtetuar e deri me 13 Prill 2024, rreth orës 12:00, saktësisht në fshatin ... rruga " ... ", Komuna Shtime, mban në posedim të paautorizuar armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armë, ashtu që natën kritike i gjendet dhe i sekuestrohet

arma - revole e llojit Automatic Bruni 96 kal.9m-mk-made in Italy me numër serik 2017 BO..., për të cilën nuk kishte autorizim,

**- Me çka kreu veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.**

## II.

**Sepse:** Me 13 Prill 2023, rreth orës 12:00, saktësisht në saktësisht në fshatin ..., rruga "...", Komuna Shtime, përdore armen në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët ashtu që gjatë një ahengu familjarë, ka përdore armen revole e llojit llojit Automatic Bruni 96 kal.9m-mk-made in Italy me numër serik 2017 B..., duke shkrepur tri herë në drejtim të malit,

**- Me këtë ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 46,47,48,69, 70,71, 72 dhe 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074), dhe neneve 364, dhe 452 par.4 të KPP-së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), të akuzuarin e :

## G J Y K O N

**1. Për veprën penale të përshkruar në dispozitivin I të aktakuzës me dënim me gjobë në shumë prej 300 €uro (treqind euro ).**

**2. Për veprën penale të përshkruar në dispozitivin II të aktakuzës me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 18 / tetëmbëdhjetë /muaj nuk kryen vepër tjetër penale.**

### **Konform neni 76 par.1 dhe 2 nënpar.2.5 të KPRK-së :**

- Të akuzuarit **R.N.**, Shqipton DENIM UNIK me gjobë në lartësi prej 300 €uro (treqind euro ) të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. dhe dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej 1/një/ viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim

- Ne rast se dënimi me gjobe nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobe, do të shndërrohet në dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do të llogaritet një dite burgu.

- Konform nenit 366 par.3, të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme: arma - revole e llojit Automatic Bruni 96 kal.9m-mk-made in Italy me numër serik 2017 B...,

-Të akuzuarin, gjykata e ka liruar nga pagesa e paushallit gjyqësor dhe taksa për Kompensimin e viktimave të kimit pasi që i njëjti nuk ka mundësi ta paguaje është veteran i luftës dhe baba i katër fëmijëve, nëse e obligonte që të paguaj edhe taksën do të rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet të i mbështes materialisht, këtë e bazon në nenin 452 par 4 të KPP-së së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032).

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.557/24 e dt.2.07.2024, ka ngarkuar të akuzuarin R.N., nga Fshati ..., Komuna Shtime, për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPP-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 12.09.2024, por me datën 19.08.2024 i akuzuari R.N., është lajmëruar në Gjykatë dhe ka njoftuar se ka me udhëtuar jashtë shtetit dhe për datën e cekur seanca nuk mundë të paraqitet por ka kërkar nëse gjykata e mban sanën gjyqësore sot është i gatshëm të merr pjesë.

Gjykata e njofton të akuzuarin R.N. se për verat penale për të cilat akuzohet si në pikën e parë dhe të dytë të aktakuzës, duhet të ketë Mbrojtje të detyruar ku bazuar në nenin 55 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 KPP-së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032 ) thuhet: se nga momenti i marrjes në pyetje për herë të parë për veprën penale të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim duhet të ketë Mbrojtje të detyruar. Pa njoftimit i akuzuar ka angazhuar mbrojtës-avokat e për këtë edhe gjykata ka njoftuar prokurorin e shtetit i cili është paraqitur në gjykatë pasi që janë paraqitur i akuzuari dhe mbrojtësi i tij.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me dt.

19.08.2024 në të cilën, prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, i akuzuari R.N. dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av. Nexhat Qorrolli.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I akuzuari R.N., në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprat penale për të cilën më ngarkon aktakuza, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat e pranimit të fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me avokaten mbrojtëse, është e vërtetë që e kam përdorur po ashtu edhe e kam pas armën të axhës, kam pas fejesën e djalit e nga emocionet e kam marrë dhe kam gjuajtur, kërkojë falje, jam penduar, premtoj se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla apo të ngjashme penale, lus gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjyqtari në kuptim të nenit 242 par.5 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), për vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit për veprën penale që akuzohet deklaroi se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ky pranim është bërë vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të lëndës, si dhe në përputhje me dispozitat e nenit 242 të KPPK-së, kërkojmë nga gjykata që të njëjtën ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë konform ligjit duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.N., Av. Nexhat Qorrolli lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se i akuzuari në këtë seancë pranoi në tërësi fajësinë lidhur me veprat penale që i vihen në barrë, pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë të vullnetshme duke i kuptuar në tërësi benefitet që i lejon ligji penal lidhur me pranimin e fajësisë, këtë e bëri në mënyrë të vullnetshme duke i kuptuar rrethanat në të cilat e ka përdorur armën e mbajtur në posedim të pa autorizuar. Me rastin e shqiptimit të dënimit- matjes së dënimit i propozoj Gjykatës që të shqiptojë një dënim sa

më të butë respektivisht institucionin e zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit duke marrë për bazë rrethanat lehtësuese se është mbajtes i familjes, është veteran i luftës, prind i katër fëmijëve, nuk është i punësuar, andaj duke përdorur rrethanat nga neni 69 dhe 70 i KPPK-së ky pranim është bërë vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të lëndës, kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj konform ligjit duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim nenit 242 par.2 nën.par.2.1, 2.2,2.3, 2.4 të KPP-së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit në provat materiale në Raportin fillestar i incidentit, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve dt.13.04.2024, fotografit si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 332 par. 4, të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 2 të KPP-së, ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata duke i vlerësuar veprimet e të akuzuarit në aspektin juridik gjeti se në verimet e tij qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv e parë dhe të dytë të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprave penale, për çka dhe i akuzuari u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për këtë veprat penale, kurse si rrethana lehtësuese mori faktin se i pandehuri është penduar thellë, premtimin se nuk do te kryej vepra të tilla penale, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale dhe mbi bazën e rrethanave të tilla Gjykata konform nenit 71 par.1 nenpar.1.2 dhe 1.3

aplikoi Institutin e zbutjes se dënimit dhe konform nenit 76 par.2 nënpar.2.5 të KPRK-të pandehurit I shqiptoj dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 / një /viti nuk kryen veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë në lartësi prej 300 ( treqind euro ), me bindjen se në rastin konkret edhe përmes këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht dhe me gjobë dhe qëllimi i përgjithshëm i dënimeve, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale duke konsideruar se një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform nenit 366 par.3, të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme: arma - revole e llojit Automatic Bruni 96 kal.9m-mk-made in Italy me numër serik 2017 B....

Vendimi mbi lirimin e pagesës së shpenzimeve të procedurës penale-paushallit gjyqësor dhe taksa për Kompensimin e viktimave të krimit është marr në kuptim të nenin 452 par 4 të KPP-së së ( Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032).

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,

**P.nr.2024:212532 me datë 21.08.2024**

**Zyrtare Ligjore**

Arbelinda Tahiri

**Gjyqtari,**

Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.